



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.4334/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Naime Ahmeti e Fatmir Baloku, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen kontestimore të paditëses "I..." sh.a. Fushë Kosovë, të cilën me autorizim e përfaqëson A. E, kundër të paditurës Komuna e Ferizajt, të cilën me autorizim e përfaqëson A.A., për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, lirimit e pronës dhe kompensimit e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses dhe ankesës së të paditurës, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.696/2017 të datës 03.02.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Me miratimin e ankesës së të paditurës Komuna e Ferizajt dhe ankesës së paditëses "I...", PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj C.nr.696/17 i datës 03.02.2020 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje të serishme.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses "I..." sh.a. Fushë Kosovë, ushtruar kundër të paditurës Komuna e Ferizajt dhe detyrohet e paditura të liroj dhe kthej në gjendje të mëparshme ngastrat kadastrale me numër 494-0 ZK Ferizaj me sipërfaqe prej 2,217 m², 1375-1 ZK Ferizaj me sipërfaqe prej 42,117 m² (sipërfaqja e uzurpuar 13,779 m², për rrugë 8,472 m², trotuar 2,267 m² dhe gjelbërim 3,040 m²),... ZK ... me sipërfaqe prej 53,582 m², në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm. Në pikën II., të dispozitivit hedhet poshtë si e palejuar padia e paditëses, ushtruar kundër të paditurës lidhur me: vërtetimin se Shteti i Kosovës është pronar i pronës dhe infrastrukturës hekurudhore, sipas gjendjes në fletët poseduese të datës 03.09.2003, menaxhere ligjore e së cilës është paditësja "I..." sh.a. Fushë Kosovë, I lejohet Komunës së Ferizajt eksproprijimi në sipërfaqe prej 13,932.4 m² pjesë

e ngastrës kadastrale ...fleta poseduese ... ZK Ferizaj, në të cilat ka bërë ndërtimin dhe zgjerimin e rrugëve, trotuareve dhe nënkalimi në rrugën ..., ..., ... dhe pjesën e rrugës për lagjen ..., ngastra kadastrale ... vendi i quajtur ... fleta poseduese ... ZK Ferizaj, tani ka sipërfaqe të mbetur prej 25,774.3 m² pronë e shtetit të Kosovës, menaxhere ligjore paditësja; detyrohet e paditura Komuna e Ferizajt të bëjë kompensimin e pronës dhe objekteve të rrënuara në të cilat ka bërë ndërtimin dhe zgjerimin e rrugëve, trotuareve dhe nënkalimit në rrugën ..., ..., ... dhe pjesën e rrugës për lagjen ..., të regjistruara në fletën poseduese ... ZK Ferizaj dhe atë ngastra kadastrale ... shtëpi banimi në sipërfaqe prej 30 m²; ngastra kadastrale ... shtëpi banimi me sipërfaqe prej 16 m²; ngastra kadastrale ... shtëpi banimi me sipërfaqe prej 63 m²; ngastra kadastrale ... shtëpi banimi me sipërfaqe prej 23 m²; ngastra kadastrale ... shtëpi banimi me sipërfaqe prej 117 m²; ngastra kadastrale ... shtëpi banimi me sipërfaqe prej 36 m²; ngastra kadastrale ... shtëpi banimi me sipërfaqe prej 53 m²; ngastra kadastrale ... shtëpi banimi me sipërfaqe prej 78 m²; ngastra kadastrale ... shtëpi banimi me sipërfaqe prej 5 m²; ngastra kadastrale ... shtëpi banimi me sipërfaqe prej 9 m²; ngastra kadastrale ... shtëpi banimi me sipërfaqe prej 54 m² dhe ngastra kadastrale ... shtëpi banimi me sipërfaqe prej 19 m²; detyrohet e paditura të bëjë kompensimin e binarit hekurudhor të depos në gjatësi prej...m, shumën prej ...Euro. Në pikën III., të dispozitivit detyrohet e paditura Komuna e Ferizajt që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës kontestimore paditëses "I..." sh.a. Fushë Kosovë në shumën prej 2,300.00 Euro, në gjitha në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij Aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë ka parashtruar paditësja, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e paditëses, prishet aktgjykimi në pjesën e atakuar dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë.

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë kanë parashtruar edhe e paditura, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës, të ndryshohet dhe të refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditëses, apo i njëjti të prishet aktgjykimi i atakuar dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit:

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesat janë të bazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, paditësja "I..." ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Ferizajt, me të cilën ka kërkuar që të urdhërohet Komuna e Ferizajt të rivendos plotësisht të drejtën e pronës së paditëses, lirim dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme sipas gjendjes në fletën poseduese të datës 3 shtator 2003 të lëshuar nga drejtoria për kadastrë, gjeodezi dhe pronësi në këto ngastra Kadastrale: ngastra Kadastrale nr.1375/1, 493-0 dhe 494-0 ZK Ferizaj, ngastra Kadastrale nr.960 ZK ... ngastra Kadastrale nr.1375/2 në sipërfaqe prej 4.06m² Fleta poseduese nr.... ZK Ferizaj dhe sipërfaqen prej 526m² të ngastrës Kadastrale 02787, Fleta Poseduese ... ZK Ferizaj/parkingu i ... Ferizaj. Të obligohet Komuna e Ferizajt të rivendos pjesërisht të drejtën e pronës-sipërfaqes së mbetur dhe kompensimin e tërë pronës së shpronësuar në të cilën është bërë zgjerimi i rrugës ... dhe kompensimin e pronës për zgjerimin e rrugës ... Objekt vlerësimi janë ngastra Kadastrale nr.2787, 2788, 2789, 2790, 2791, 2794, 2795, 2798, 2800 vendi i quajtur ... dhe 2805, vendi i quajtur Hekurudha ZK Ferizaj, fleta poseduese ..., me që rast do të caktohet sipërfaqja totale: sipërfaqja e vlerësuar për kompensim dhe sipërfaqja e mbetur për rivendosje të së drejtë së pronës . Të urdhërohet e paditura Komuna e Ferizajt që të bëjë dislokimin e tërë infrastrukturës rrugore të vendosur në brezin hekurudhor në ..., përgjatë vijës hekurudhore në drejtim të Shkupit në largësi prej së paku 7 metrave nga aksi i binarit anësor. Të obligohet e paditura të bëjë kompensimin e të gjitha objekteve të rrënuara të hekurudhës të regjistruara në fletën poseduese nr.... ZK Ferizaj të këtyre ngastrave Kadastrale: 0... me kulturë shtëpi-ndërtesë me sipërfaqe 19m², 0... me kulturë shtëpi-ndërtesë me sipërfaqe 54 m², 0... me kulturë shtëpi-ndërtesë me sipërfaqe 9m², 0... me kulturë shtëpi-ndërtesë me sipërfaqe 5m², 0... me kulturë shtëpi-ndërtesë me sipërfaqe 53m², 0... me kulturë shtëpi-ndërtesë me sipërfaqe 36m², 0... me kulturë shtëpi-ndërtesë me sipërfaqe 117m², 0... me kulturë shtëpi-ndërtesë me sipërfaqe 23m², 0... me kulturë shtëpi-ndërtesë me sipërfaqe 78m², 0... me kulturë shtëpi-ndërtesë me sipërfaqe 63m², 0... me kulturë shtëpi-ndërtesë me sipërfaqe 16m² dhe 0... me kulturë shtëpi-ndërtesë me sipërfaqe 30m². Të obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij aktgjykimi. Të obligohet e paditura Komuna e Ferizajt të bëjë kompensimin për pronën e shpronësuar dhe kompensimin për objektet e rrënuara në shumën e caktuar nga Ministria e Financave në afat prej 15 ditëve. Të obligohet e paditura që të bëjë të gjitha shpenzimet e procedurës gjyqësore.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat si: Fleta posedues e nr. ... e datës 03.09.2003, Aktvendimi i datës 17.07.2008, Aktvendimi i datës 05.08.2008, Përgjigjja në kërkesë e datës 10.12.2013, Pëlqimi i datës 30.07.2008, Kërkesa e datës 03.10.2008, Memorandumi i mirëkuptimit i dt.23.09.2008, Marrëveshje e mirëkuptimit e dt. 05.10.2016, Vendimi preliminar i datës 03.10.2016, Kërkesa e datës 29.09.2016, Vendimi i datës 05.10.2016, 10-Nr.465-9,

Certifikatat e pronësisë të dt. 15.06.2016 (10x), Certifikata e pronësisë dt. 13.02.2017, Raportet ekspertëve gjeodet të datës 02.02.2017, 25.02.2019 dhe 30.04.2019, Parashtrësia datës 16.11.2017, Certifikata të pronësisë të dt. 13.02.2017, Konkluzioni i datës 17.07.2017, Aktvendimi i datës 13.12.2007, Aktvendimi dt. 04.05.2006, Raporti i vlerësimit i datës Maj 2019.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike se: paditësja në regjistrat kadastral në këtë periudhë është regjistruar poseduese e parcelave objekt kontesti, përkatësisht parcelave 2787, 2789, 2790, 2791, 2794, 2796, 2798, 2799, 2801, 2802, ..., ..., 2804, 1375-1, 494. Ngastrat kadastrale 2800, 2787, 2788, 2789, 2790, 2791, 2794, 2795, 2798 në vendin e quajtur "...” me kulturë tokë ndërtimore të regjistruara në certifikatën nr.... i merren paditëses dhe kalojnë tek e paditura për shkak të shpalljes së interesit të përgjithshëm. Ngastrat kadastrale 2800, 2787, 2788, 2789, 2790, 2791, 2794, 2795, 2798 në vendin e quajtur "...” me kulturë tokë ndërtimore të regjistruara në certifikatën nr.... në emër të paditëses dhe të njëjtat bartet në emër të Komunës së Ferizajt, për rregullimin, ndërtimin e rrugëve, parqeve, vendeve të gjelbëruara etj. E paditura ka njoftuar paditësen për shpalljen e interesit të përgjithshëm për Parcelat Kadastrale si më poshtë: 2787, 2788, 2789, 2790, 2791, 2794, 2795, 2798, dhe 2800 të gjitha ZK Ferizaj. Paditësja ka dhënë pëlqimin të paditurës për hapjen e rrugës nga K.K deri te vend kalimi "...”, "...” dhe "...”, po ashtu paditësja jep pëlqimin për rrënimin e objekteve në sipërfaqen e pronës ku parashihet zgjerimi i rrugëve. E paditura i është drejtuar paditëses për largimin e binarit të parë me datë 02.10.2008. Në mes paditëses dhe të paditurës është lidhur marrëveshje bashkëpunimi në drejtim të zhvillimit të hapësirës përreth stacionit hekurudhor të Ferizajt, duke eliminuar ndërtimet pa leje në pronën e ... dhe duke rregulluar infrastrukturën e kësaj hapësire në të mirën publike të qytetarëve Ferizajas dhe të Hekurudhave të Kosovës SHA, kryetari i Komunës së Ferizajt M. S dhe kryeshefi ekzekutiv i paditëses A. Th janë zotuar për zgjidhjen e çështje pronësore dhe atë: e paditura nuk do të ndërmerr asnjë aktivitet apo të zhvilloj punime në pronat e paditëses, që janë lëndë e masës së përkohshme të sigurimit të vendosur me Aktvendimin CN.nr.709/13 të datës 11.02.2014, janë zotuar që mosmarrëveshjet eventuale në mes palëve ndërgjyqëse t'i zgjidhin me mirëkuptim. E paditura ka aprovuar shpronësimin për interes të përgjithshëm publik, përkatësisht asfaltimi i rrugëve përgjatë hekurudhës. E paditura, përkatësisht Drejtoria për Infrastrukturë ka kërkuar nga Drejtoria për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër që të shpallë interes të përgjithshëm të parcelave që përfshin rruga përgjatë hekurudhës nga "...” deri te rruga "...”. Parcelat 01375-1 ZK Ferizaj me sipërfaqe prej 42,117 m², 00960-0 me sipërfaqe prej 53,582 m², 02795-0 ZK Ferizaj me sipërfaqe prej 63 m², 0... me sipërfaqe prej 117 m² ZK Ferizaj, 0... me sipërfaqe prej 53 m² ZK Ferizaj, 02797-0 me sipërfaqe prej 56 m² ZK Ferizaj, 02800-1 me sipërfaqe prej 320 m² ZK Ferizaj, 0... me sipërfaqe prej 54 m² ZK Ferizaj, janë të regjistruara në regjistrat kadastral në emër të paditëses, ndërsa parcela me numër 02787-1 me sipërfaqe prej 19,011 m² është e regjistruar në regjistrat kadastral

në emër të të paditurës, 0... me sipërfaqe prej 9 m², 0... me sipërfaqe prej 5 m², 0... me sipërfaqe prej 19 m² ZK Ferizaj, janë të regjistruara në emër të paditëses. Parcela me numër 0... me sipërfaqe prej 36 m² ZK Ferizaj është e regjistruar në regjistrat kadastral në emër të paditëses. Parcela 2787-0 ka sipërfaqe 39,706 m² e cila shtrihet nga rreth rrotullimi i cili gjendet te objekti i FSK-së dhe vazhdon në drejtim të Shkupit deri te mbarimi që gjendet parku, gjegjësisht deri te ... në anën e majtë të rrugës Ferizaj ..., kjo parcelë është copëtuar tri herë dhe atë 2787-1, 2787-2 dhe 2787-3. Nga këto njësi, parcelat 2787-1 me sipërfaqe prej 19,011 m² dhe 2787-3 me sipërfaqe prej 12,000 m² kanë ndërruar pronësinë dhe tani janë në emër të të paditurës, përmes Aktvendimit 03.Nr.465/4 të datës 23.09.2010, të cilat sipërfaqe të marra janë shtruar me rrugë-asfalt, trotuar dhe gjelbërim në sipërfaqe të tërësishme prej 20,695 m². Në pronësi të paditëses ka mbetur parcela me numër 2787-1 me sipërfaqe prej 19,011 m². Parcela me numër ... me sipërfaqe prej 117 m², e cila sipas evidencës ka qenë objekt në tërë sipërfaqen e saj, ndërsa 80 m² është mbuluar me rrugë-asfalt, pjesa tjetër është në kuadër të hapësirës së lirë, parcela 2797-0 me sipërfaqe prej 56 m², e cila është objekt, është e evidentuar në emër të paditëses, parcela me numër ... me sipërfaqe prej 36 m², sipas evidencës ka qenë objekt tani i rrënuar, 22 m² të saj janë të mbuluar me rrugë-asfalt, ndërsa pjesa tjetër shfrytëzohet nga ..., parcela me numër ... me sipërfaqe prej 53 m², në këtë parcela ka qenë ndërtuar një objekt dhe tani nuk ekziston, ndërsa këtu tani gjendet ..., parcela me numër 2800-0 me sipërfaqe prej 1,029 m², tani është ndarë 2800-1 dhe 2800-2, e cila kjo e fundit ka kaluar në emër të të paditurës (sipërfaqja 709 m²), parcela 2802 me sipërfaqe prej 5 m², e cila ndodhet në kuadër të hekurudhës, parcela ... me sipërfaqe prej 9 m², në të cilën ka qenë ndërtuar një objekt dhe tani nuk ekziston, parcela ... me sipërfaqe prej 54 m², sipas evidencës ka qenë objekt , tani nuk ekziston por është shtruar me asfalt dhe trotuar, parcela ... me sipërfaqe prej 19 m², në të cilën ka qenë ndërtuar një objekt, tani nuk ekziston është rrugë me asfalt, parcela 2805-0 me sipërfaqe prej 753 m², e cila ka qenë kullosë, tani shfrytëzohet si park dhe fushë e basketbollit, parcelat 2788-0 me sipërfaqe prej 9 m², e regjistruar në emër të të paditurës, ... me sipërfaqe prej 30 m², në emër të të paditurës, ... me sipërfaqe prej 16 m², ... me sipërfaqe prej 63 m², në to është ndërtuar parku i qytetit. Parcelat 0... me sipërfaqe prej 30 m², 02788-0 me sipërfaqe prej 9 m², 02787-2 me sipërfaqe prej 8,695 m², 02787-3 me sipërfaqe prej 12,000 m², 02800-2 me sipërfaqe prej 709 m², 0... me sipërfaqe prej 63 m² dhe 0... me sipërfaqe prej 23 m² të gjitha ZK Ferizaj janë të regjistruar në emër të të paditurës në regjistrat kadastral. E paditura e ka në shfrytëzim dhe posedim që nga fillimi dhe atë ngastrën kadastrale 169-2 me sipërfaqe prej 9,828 m², 171-3, 172-3, 173-2, 174-3, 177-2, 1372-2 ZK ... dhe 512, e të cilat ngastra të regjistrohen si rrugë publike KK Ferizaj.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK-së: “Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK-së: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:c) ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta kthej çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë”.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Gjykata e Apelit e Kosovës përfundimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta pranoj si të ligjshëm dhe të drejtë dhe konsideron se aktgjykimi i atakuar, është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pikën n), për arsye se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, nuk janë dhënë arsye të plota mbi faktet vendimtare dhe dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me arsyet e aktgjykimit.

Kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se, në arsyetimin e aktgjykimit ndër të tjera gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në rastin konkret bëhet fjalë për kufizim të të drejtave të pronësisë për interes të përgjithshëm publik nga ana e të paditurës, mirëpo e paditura Komuna Ferizaj, nuk e ka respektuar Ligjin për Shpronësimin, kur ka shpallur interesin e përgjithshëm për pronat e paditëses, për arsye se një të drejtë të tillë e ka vetëm Qeveria e Kosovës. Kolegji gjen se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në këtë pikë, nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare, nëse vendimet e të paditurës mbi shpalljen e interesit publik dhe përfundimin e procedurës së eksproprijimit janë dorëzuar në formën e paraparë ligjore tek paditësja dhe nëse vet paditësja apo cilido organ tjetër shtetëror dhe vet Qeveria e Kosovës, ka ndërmarrë cilën do procedurë ligjore në drejtim të kontestimit të vendimeve të tilla, a ka përfunduar një procedurë e tillë administrative, në cilën fazë gjendet procedura e tillë etj.

Kolegji gjen se nga një mosdhënie e arsyeve dhe vërtetim i fakteve vendimtare, nuk është vërtetuar në mënyrë dhe masë të plotë gjendja faktike dhe si rezultat i kësaj është zbatuar në mënyrë të gabuar edhe e drejta materiale. Sipas vlerësimit të kolegjit këto kanë ndikuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë mbetet i pa qëndrueshëm në pikëpamje të

qëndrueshmërisë së tij juridike. Lidhur me pikat tjera të dispozitivit të aktgjykimit për të cilat është refuzuar kërkesëpadija e të paditurës për shkak të mosndërmarrjes së veprimeve nga ana e të paditurës për rregullimin e tyre në pikëpamje të përcaktueshmërisë së kërkesëpadijes dhe legjitimitetit, Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se, një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë ka qenë dashur që ta evitoj në fazën përgatitore ku edhe zhvillohen veprimet lidhur me mirë përgatitjen e procesit kontestimor dhe ku do të ndërmerreshin veprimet ligjore konform nenit 99 dhe 102 të LPK-së dhe që të mos vazhdohet me procesin kontestimor, duke pasur para vetes një kërkesëpadi të pa qartë në pjesën më të madhe të pikave të saj.

Për arsyet e sipër theksuara kolegji gjen se qëndrojnë pretendimet ankimore të paditëses dhe të paditurës dhe që çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në procedurën e rigjykimit gjykata e shkallës së parë udhëzohet që t'i ndërmarr veprimet nga neni 99 dhe 102 të LPK-së, lidhur me qartësinë e kërkesëpadijes me qëllim të eliminimit të të metave në drejtim të përcaktueshmërisë së kërkesave dhe ekzistimit të legjitimitetit. Kjo sepse, kërkesëpadija është pjesa qendrore e kërkesëpadijes lidhur me të cilën do të duhet të vendos gjykata për kërkesat e palëve në procedurë. Paqartësia dhe pa përcaktueshmëria e kërkesëpadijes e bënë padinë të mangët në pikëpamje formale dhe kjo rrethanë e pamundëson punën e gjykatës lidhur me të.

Gjykata e shkallës së parë udhëzohet gjithashtu që të vërtetoj faktet në procedure dhe të jap arsye të plota dhe përgjigje lidhur me prapësimet materialo juridike, të palës së paditur lidhur me ekzistimin e vendimeve të formës së prerë të nxjerra në procedurën administrative, lidhur me procesin e shpronësimit dhe nëse vendimet e tilla lidhur me realizimin e të drejtave subjektive të palëve në procedure, nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare, nëse vendimet e të paditurës mbi shpalljen e interesit publik dhe përfundimin e procedurës së eksproprijimit janë dorëzuar në formën e paraparë ligjore tek paditësja dhe nëse vet paditësja apo cilido organ tjetër shtetëror i paraparë me ligj, ka ndërmarrë cilën do procedurë ligjore në drejtim të kontestimit të vendimeve të tilla, a ka përfunduar një procedurë e tillë administrative, në cilën fazë gjendet procedura e tillë etj.

Gjykata e shkallës së parë të bëjë vërtetimin e fakteve të tjera relevante në procedurë, dhe pas vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe aplikimit të drejtë të së drejtës materiale, gjykata e shkallës së parë do të marr një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj, në këtë çështje kontestimore.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika c) të LPK-së, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4334/2020, me datë 12.04.2024

Kryetari i kolegjit - gjykatësi,

Dr.sc. Rafet Haxhaj